



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS**

---

**V E N D I M**

**Nr. 123    Datë 18.09.2009**

**Për**

**“Vendosje gjobe ndaj shoqërisë Albanian AirLines MAK Sh.p.k.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati)      Kryetar
- Znj. Servete Gruda          Anëtar
- Zt. Koço Broka              Anëtar
- Znj. Rezana Konomi        Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.09.2009, shqyrtoi çështjen me :

**Objekt:** Mbi shkeljen e procedurave që parashikon ligji në përqëndrimin e realizuar mes ndërmarrjeve Albanian Airlines MAK Sh.p.k dhe Advanced Construction Group Sh.p.k.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, shkronja d, neni 74, gërmat ç dhe d, neni 73, pika 1, shkronja b dhe vendimet nr 100 dhe 112 të Komisionit të Konkurrencës

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e datës 08, 17 dhe 18 shtator 2009, pas shqyrtimit të raportit dhe relacionit të Sekretares së Përgjithshme, mbi përqëndrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Albania AirLine MAK Sh.p.k. nga shoqëria Advanced Construction Group Sh.p.k. dhe seancës dëgjimore të zhvilluar me palët me datë 26 korrik 2009,

## V Ë R E N S E:

### I. Palët:

**Shoqëria Albanian AirLines MAK Sh.p.k** (këtu e më poshtë referuar si “Albanian AirLines”), në cilësinë e shitësit, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit shqiptar, me seli në adresën: Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit “Green Park”, K 2, Po. 19, Tiranë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar të Tiranës me NIPT Nr. J61827030N.

**Shoqëria Advanced Costruction Group** (këtu e më poshtë referuar si “Advanced Costruction”), në cilësinë e blerësit, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit shqiptar, me seli në adresën: Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit “Green Park”, K 6, Po. 19, Tiranë, e regjistruar ne Rregjistrin Tregtar të Tiranës me NIPT Nr. K32022002F.

### II. Përqëndrimi i realizuar

Shoqëritë Albania AirLines MAK Sh.p.k. dhe Advanced Construction Group Sh.p.k. në datën 04 Korrik 2008<sup>(1)</sup>, kanë nënshkruar një marrëveshje me objekt shit-blerje 100 % të kuotave nga shoqëria “Albania Airlines” te shoqëria “Advanced Construction”.

Ky transaksion, në kuptim të nenit 10, pika 1, gërma b të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (këtu e si vijon Ligji) konsiderohet përqëndrim.

Transaksioni përmbush edhe kriteret e përcaktuara në nenin 12, pika 1 e Ligjit dhe si rrjedhim duhet të njoftohet në Autoritetin e Konkurrencës, në afatin e përcaktuar në pikën 2 të nenit 12 të Ligjit nr.9121 “Per mbrojtjen e konkurrencës”.

### III. Procedura e ndjekur

Palët nuk kanë njoftuar përqëndrimin e realizuar në kuptim të nenit 12, pika 1 e Ligjit brenda një jave nga realizimi i trasaksionit. Autoriteti i Konkurrencës, pasi ka vërtetuar se palët në transaksion, në kuptim të nenit 12, pika 2, të Ligjit përmbushin edhe kriteret e xhiros për të njoftuar përqëndrimin e realizuar është shprehur me Vendimin Nr. 100, datë 03.02.2009, “Hapjen e procedurës së kontrollit të pëqendrimit të realizuar nëpërmjet “Shitblerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Albania AirLine MAK Sh.p.k. nga shoqëria Advanced Construction Group Sh.p.k.”.

Shoqëria Albania AirLines MAK Sh.p.k. është njoftuar për Vendimin me shkresën Nr. 485/6 Prot, datë 04.02.2009.

---

<sup>1</sup> Sipas marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve të noterizuar

Me shkresën Nr. 485/7 Prot, datë 24.03.2009, Sekrateriati ka bërë me dije shoqërinë Albania AirLines MAK Sh.p.k., mbi penaltetet që rrjedhin nga mospërbushja e detyrimit ligjor për të depozituar të dhëna të plota për shqyrtimin e përqendrimit.

Shoqëria nuk i është përgjigjur shkresën nr 458/7 prot të datës 24.03.2009 të Autoritetit të Konkurrencës.

Me vendimin Nr. 112, datë 15.05.2009 ( ) “Për tërheqje të dhënash nga shoqëria Albanian AiLines Mak Sh.p.k.”, Komisioni i Konkurrencës kërkoi nga shoqëria Albanian Airlines dërgimin e informacionit mbi përqëndrimin e realizuar. Vendimi iu njoftua shoqërisë Albanian AirLines Mak Sh.p.k me shkresën Nr. 485/8 Prot, më datë 19 Maj 2009 dhe është marrë në dorëzim nga përfaqësuesit e shoqërisë.

Por shoqëria objekt-përqëndrimi nuk i është përgjigjur kërkesave për informacion që nga momenti i hapjes së procedurës së kontrollit të përqendrimit me nismën e Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 59 të Ligjit.

Me datë 26 korrik 2009 Komisioni i Konkurrencës në zbatim të nenit 39 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dëgjoi palët për pretendimet e tyre lidhur me shkëljet e Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” lidhur me përqëndrimin e realizuar. Palët kërquan 15 ditë kohë për të paraqitur provat e tyre, por edhe pas përfundimit të këtij afati pranë Autoritetit të Konkurrencës nuk është depozituar asnjë shkresë nga palët pjesëmarrëse në përqëndrimin e realizuar.

Nga analiza e konkurrencës konstatohet se përqëndrimi i realizuar nuk sjell pasoja për konkurrencën në treg, pasi kemi një zëvendësim të pronësisë të një ndërmarrje nga një ndërmarrje tjetër, në tregje të ndryshme përkatëse të produktit dhe për këtë arsye Komisioni i Konkurrencës e ka autorizuar përqëndrimin e ndodhur në mbledhjen e datës 17.09.2009 me Vendimin Nr.122.

\* \* \* \*

Komisioni i Konkurrencës vlerëson se palët pjesëmarrëse në transaksion, Shoqëritë Albania AirLines MAK Sh.p.k. dhe Advanced Construction Group Sh.p.k, kanë shkëlur ligjin me mosnjoftimin e përqendrimit pranë Autoritetit të Konkurrencës, realizimin e përqendrimit duke mos respektuar detyrimin ligjor për Autorizim nga Autoriteti i Konkurrencës dhe depozitimin e informacionit jo të plotë brenda afatit kohor.

Duke qene se transaksioni i realizuar per perftimin e kontrollit nga shoqeria Albania AirLines MAK Sh.p.k ne Advances Constuction Group Sh.p.k nuk sjell efekte ne treg, Komisioni i Konkurrences ne vendimmarrjen e tij eshte bazuar vetem ne nenin 73, pika 1, shkronja b.

## PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d); 73, pika 1, shkronja a); neni 80 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

### VENDOSI:

1. Gjobitjen e Shoqërisë Albania AirLines MAK Sh.p.k. në masën 2 600 000 lekë.
2. Ngarkohet Njësia e Hetimit Tatimor që në bazë të nenit 80 të Ligjit Nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të kryejë ekzekutimin e gjobës në shumën e mësipërme.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe Njësinë e Hetimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I KONKURRENCËS

**Servete Gruda**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Koço Broka**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Rezana Konomi**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**LINDITA MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**KRYETAR**

## MENDIMI I PAKICËS

Lidhur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr.123, Datë 18.09.2009 “Për Vendosje gjobe ndaj shoqërisë Albanian Airlines MAK Sh.p.k”, kam mbajtur qëndrim kundra me arsyetimin e mëposhtëm :

I-Lidhur me bazën ligjore të Vendimit

Përsa i përket dispozitivit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës të datës 8/09/2009 ” Për Vendosje gjobe ndaj shoqërisë Albanian Airlines MAK Sh.p.k” në bazën ligjore të saj vërehet një mospërputhje jo vetëm me bazën e dispozitivit, por edhe brenda vetë bazës ligjore të objektit të vendimit. Kështu si bazë ligjore shërbejnë të dy nenet e gjobave edhe 73 edhe 74 që njëkohësisht i korrespondojnë shkeljeve të ndryshme: -gjobave për shkelje të lehta (neni 73);

-gjobave për shkelje të rënda;

Praktikisht, por edhe teorikisht një gjë e tillë është të paktën e pamundur referuar të njëjtit segment kohor të dhënë. Edhe në se marrim mundësinë teorike të ekzistencës së tyre, nuk mund të aplikohen paralelisht, pasi rtë paktën njëra prej tyre duhet të kishte ndodhur më përpara në kohe se tjetra dhe duhej me të njëjtin argumentim të ishte ndëshkuar më parë. Në këtë mënyrë mund të kishte shërbyer si mjet për të parandaluar “shkelësin” të kryente shkeljen e dytë.

-Për më tepër për njërën nga shkeljet megjithëse aludohet të jetë kryer nga palët pjesmarrëse në përqëndrim, nuk specifikohet se përse hiqet dorë në bazën ligjore të dispozitivit. Konkretisht megjithëse në pjesën vërejtëse përsëri referohet shkelja e kryer bazuar në nenin 74, gërmat ç dhe d, në fund në dispozitiv kjo shkelje nuk përmendet më dhe nuk sqarohet se cilat kanë kushtet që kanë rrëzuar pretendimin për një shkelje të bazuar në nenin 74 sikur është shënuar në bazën e objektit të vendimit në fjalë, si dhe në gjithë pjesën konstatuese të saj. Nga ky shkak rezulton që të mos qëndrojë edhe paragrafi i parafundit i pjesës konstatuese në faqen 4 të vendimit, (para fillimit të dispozitivit).

Për Palën Albania Airlines pretendohet se ka kryer një përqëndrim sipas nenit 10 të Ligjit 9121, datë 28.07.2003 dhe këtë nuk e ka njoftuar në Autoritet brenda periudhës të përcaktuar në nenin 12 të ligjit 9121, date 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Kjo cilësohet si shkelja e parë e kryer nga kjo shoqëri, dhe që sipas bazës ligjore të objektit të vendimit do duhet të ndëshkohet sipas nenit 74 të Ligjit. Kjo shkelje nuk përmendet më në dispozitiv.

Lidhur me këtë shkelje do të mjaftonte vetëm heqja dorë prej saj në dispozitiv që të provonte se një aludim i tillë është I pa bazë. Megjithatë do të desha të evidentoja se nga përgjigjet e ardhura në Autoritet nga subjekti Albania Airlines gjithmonë është hedhur poshtë një pretendim i tillë i sekretariatit. Asnjëherë Albanian nuk ka pranuar se jemi para rastit të përcaktuar në dispozitën e nenit 10 të Ligjit 9121. Kjo pohohet edhe në vet vendimin, si dhe në vendimin tjetër për autorizimin e këtij përqëndrimi. Kështu në paragrafin e fundit të vendimit citohet se “ ... kemi një zëvendësim të pronësisë të një ndërmarrjeje nga një ndërmarrje tjetër, në tregje të ndryshme përkatëse të produktit...”.

Pra gjatë argumentimit të shoqërisë objekt kontrolli, në vendim nuk provohet ekzistencën e një rasti përqëndrimi, madje e kundërta gjë që e kanë provuar disa here përfaqsueti e Albanian.

II- Përsa i përket dispozitivit të Vendimit për gjobitjen mbi bazën e nenit 73, konfirmoj se për korrektesë ndaj Autoritetit të Konkurrencës subjekti Albanian fillimisht i solli të dhënat. Trajtimi në mënyrë këmbëngulës i këtij rasti si përqëndrim, (kur për mendimin tim, si dhe ne vijim të opinioneve të mija të shprehura dhe me pare ne mbledhjet zyrtare të Komisionit, kemi të bejme vetëm me një transaksion shit-blerje), solli mos përgjigjen më të këtij subjekti duke e parë si të pashmangshme zgjidhjen e konfliktit në sistemin gjyqësor që mund të na rrezikojë edhe dëmshpërblimin e mungura në rast të rrëzimit të pretendimeve tona si institucion.

Sa më sipër duke mos qenë tërërisht dakord me vlerësimin e fakteve të bëra në argumentet e pjesës konstatuese të vendimit, hartuar nga shumica, nuk mund të jem dakord dhe të miratoj dhe dispozitivin e këtij vendimi i cili është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e atyre konstatimeve.

**Prandaj çmoj që për dispozitivin e vendimit dhe këtë të fundit në përgjithësi të jap votën kundër.**

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Koço BROKA**  
(          )  
Anëtar